



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 12661 Prot

Shkodër, më 29/05 /2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi per miratim: *“Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime”sh.a Tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.*

KESHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë, Referuar ligjit 139/2015 "Per veteqevcrisjen vendore" të ndryshuar, VKB nr. 60, date 28,12,2020, "Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit Të Keshillit bashkiak Shkoder", bashkengjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt vendimin per miratim: *“Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime”sh.a Tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.*

Duke Ju uruar punë të mbarë!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

**ZV/KRYETAR
Rudin BEKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 12664 Prot

Shkodër, më 29.05.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____, ____/2026

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 200 M² TË PASURISË SË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME" SH.A TEK MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës, _____, ____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, nenit 54 pika e, Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; VKM nr.432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër, Vendim i Asamblesë së Përgjithshme nr.7 datë 28.05.2026 "Për miratimin në parim të kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime Shkodër" sh. a. tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", Shkresë nr.4480, datë 17.06.2025 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" dhe sipas relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" sh.a Shkoder tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë të pasurisë të sipërcituar duke bashkërenduar punën me Ministrinë e e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
Z / KRYETAR
Rudin BEKA**



Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane

Valdo DIBRA

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve

Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria Juridike

Brikena LEQEJZA

Drejtoria e Përgjithshme

Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Mikel KAPSAJ



Konceptoi: A. Gjoka (Specialist)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE**

Nr. 12661/12 Prot

Shkodër, më 29/05 /2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 200 M² TË
PASURISË SË SHOQËRISË “TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA
PERIME”SH.A TEK MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Shkoder ka paraqitur materialin pranë Këshillit Bashkiak Shkoder, me objekt:

“Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime”sh.a Tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural paraqitet për shqyrtim propozimi për transferimin e një sipërfaqeje prej 200 m², pjesë e pasurisë në pronësi të Shoqërisë, në favor të institucionit shtetëror përkatës, për realizimin e funksioneve.

Kjo nisëm ndërmerret duke u nisur nga shkresa nr. 4480 Prot, datë 17.06.2026 te Ministrisë së Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë me lëndë; *Kërkesë për transferim të një sipërfaqeje toke të bashkisë për nevoja të sigurisë ushqimore pranë Ministrisë së Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë.* Mbi sipërfaqen e tokës-truall prej 31,316 m² në pronësi të “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime” Sh.a. ndodhet AKU Drejtoria Rajonale Shkodër pranë të ciles kerkohet të transferimi. Nga verifikimet në terren dhe dokumentacioni teknik rezulton se institucioni shtetëror ushtron aktivitetet në këtë territor të rrethuar, në funksion të ushtrimit të kompetencave në fushën e kontrollit dhe sigurisë ushqimore dhe kërkesa aktuale për transferimin e një sipërfaqeje prej 200 m² lidhet funksionalisht me nevojat operacionale dhe institucionale të strukturave shtetërore përgjegjëse për sigurinë ushqimore.

Shoqëria “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime”sh.a shoqëri në pronësi të Bashkisë Shkodër e cila është transferuar me VKM nr.432, datë 19.07.2023 “Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë “Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime”,Sh.a Shkodër,nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër” rezulton se zotëron dokumentacion të rregullt pronësie,dhe të paisur me Çertifikatë Rregjistrim Pasurie me Kod Unik:1495018155 për pasurinë nr.152/19 ,ZK 1495 Adresa: Dobrac, Bashkia Shkodër; me sip totale 31316 m² të llojit truall + arë nga ku 4055.4 m²truall dhe 1351.5 ndërtesë.

Nga analiza teknike,funksionale sipas dokumentacion të paraqitur nga shoqëria dhe vendimarrjen se saj rezulton se sipërfaqja prej 200 m² nuk cënon funksionalitetin kryesor të

aktivitetit të Shoqërisë; nuk pengon ushtrimin e veprimtarisë tregtare dhe operacionale të saj; dhe mund të vihet në dispozicion për interes publik institucional.

Duke qenë se Shoqëria është me kapital 100% në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe pasuria rezulton e regjistruar në pronësi të Shoqërisë, është e nevojshme vendimarrja e Këshillit Bashkia për vijimin e procedurës.

Përsa më sipër vlerësojmë se ky propozim gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Per transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; VKM nr.432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër, Vendim i Asamblesë së Përgjithshme nr.7 datë 28.05.2026 "Për miratimin në parim të kërkesës për transferimin e sipërfaqës 200 m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime Shkodër" sh. a. tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural",

Sa me sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë propozimin : "Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200 m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime" sh.a Tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z. KRYETAR

Rudin BEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH. A.
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 75 Prot

Shkodër, më 28.05.2026

V E N D I M

Nr. 7 datë 28.05.2026

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQËS
200 M² TË PASURISË SË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA
PERIME SHKODËR" SH. A. TEK MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL.**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "Tregu i shitjes me shumice fruta perime Shkodër" Sh.a., e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar; të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër", Statutit të Shoqërisë.

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të kërkesës për transferim të sipërfaqes prej 200 m² tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .

PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME

KRYETARI

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH.A
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Nr. 66 prot.

Shkodër, më 15 .05 .2026

VENDIM

Nr. 3 Datë 25/05/2026

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQËS
200 M² TË PASURISË SË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA
PERIME SHKODËR" SH. A. TEK MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL**

Këshilli i Administrimit i Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a Shkodër, mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a. Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër"; Statutin e Shoqërisë, Relacionin e Administratorit dhe dokumentacionin teknik dhe juridik të administruar,

VENDOSI:


1. Miratimin në parim të kërkesës për transferim të sipërfaqes prej 200 m² , pjesë e pasurisë nr. 152/19, ZK 1495, pronë e Sh.a , tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .
2. Shoqëria "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a të marrë masat e duhura administrative, procedurale dhe ligjore për ndjekjen e procedurave pas vendimarrjes së Keshillit Bashkiak Shkoder .

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Denisa Domni

Elvin Brahim

Griselda Dama



Nr. 24 Prot.
Dt. 01.03.2026

Tregu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4354 Prot

Shkodër, më 24/02/2026

Lënda: Kërkesë për fillim të procedurave administrative.

TREGU SHUMICË FRUTA PERIME SH.A

DOBRAÇ

Dërgim kërkesë me qëllim trajtimin e shkresës nr. 4480 datë 17.6.2025 "kërkesë për transferim të një sipërfaqe toke pronë e bashkisë për nevoja të sigurisë ushqimore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe shkresës Nr. 1708/2 prot., datë 14.10.2025, dërguar nga Autoriteti kombëtar i ushqimit, drejtoria rajonale Shkodër. Në vijim të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe AKU bashkia Shkodër duhet të sigurojë një sipërfaqe toke prej 200 m² për të cilën do të ndiqen procedurat përkatëse për transferim pranë MBZHR në kuadër të zbatimit të projektit CRAD për ndërtim të një magazine të mallrave ushqimore, pranë AKU.

Në kuadër të kësaj kërkesë, kërkojmë nga ana juaj marrjen e masave dhe vijimin e procedurave administrative të Sh.A. për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm, për transferim të kësaj sipërfaqeje.

Në vijim, ky dokumentacion do ti paraqitet Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim të transferimit të pronësisë.

Duke Ju falenderuar, mbesim në pritje!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DËGELGIMI

Zv. KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Nr 4480 Prot.

Tiranë, më 17.06.2025

Lënda: Kërkesë për transferim të një sipërfaqe toke pronë e bashkisë për nevoja të sigurisë ushqimore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Z. BENET BECI
KRYETAR I BASHKISË

Adresa: Rruga "13 Dhjetori", ndërtesa 9, hyrja 1, 4001

Shkodër

I nderuar Z. Kryetar,

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) nëpërmjet projektit "*Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë CRAD*", synon ndërtimin e një magazine të mallrave ushqimore të dyshuara pranë Agjencisë Rajonale të Ushqimit (AKU) në kuadër të zbatimit të programit qeverisës, lidhur me sigurinë ushqimore.

Nëpërmjet strukturave të MBZHR dhe AKU-se ne kemi identifikuar një sipërfaqe toke pranë laboratorit të kontrollit të ushqimeve, AKU Shkoder në pjesën e pasme të rrethimit të këtij laboratorit, pasuria me emërtim "Tregu i shitjes me shumicë fruta -perime".

Sipërfaqja e tokës së pretenduar nga ana e jonë, për nevoja të sigurisë ushqimore, ku është e domosdoshme ndërtimi i strukturës "*magazinë e mallrave ushqimore të dyshuara*" është pjesë e pasurisë së sipërcituar me numër 152/19, zona kadastrale 1495, në zërin kadastral "arë dhe truall". me sipërfaqe gjithsej 31316m², nga e cila truall 4055.2m² dhe ndërtesë 1351.5m². Sipërfaqja e kërkuar për magazinë është rreth 200 m².

Në takimet e përfaqësuesve të MBZHR me përfaqësues të institucionit Tuaj, ku ju kemi bërë me dije nevojën e ndërtimit të kësaj strukture, si dhe ana e Juaj është shprehur në parim dakortësia për transferimin e kësaj sipërfaqe, pjesë e pasurisë së sipërcituar, pasuri në pronësi të bashkisë Shkodër tek MBZHR për nevojat e AKU-së, për ndërtimin e magazinës magazinë e mallrave ushqimore të dyshuara.

REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLEMIS
AUTORITETI KOMBETAR I USHQIMIT
DREJTORIA RAJONALE SHKODER
SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE TE BRENDSHME

1708/2 prot

NR. DERGUAR
LENDA
20987 1640.25

Shkodër, më 14.10.2025

Lenda : Kërkesë për informacion shtesë mbi ecurnë e procedurave për ndërtimin e një
magazine frigoriferike ushqimore në kuadër të projektit CRAD

ZBENET BECI
KRYETAR I BASHKISE SHKODER

Në vijim të shkresës Nr.1708/1 prot., datë 04.07.2025 lidhur me kërkesën për mbështetje
institucionale në ndërtimin e një magazine frigoriferike ushqimore në kuadër të projektit CRAD,
ju bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së na ka kërkuar informacion shtesë në
lidhje me fazën aktuale të procedurave administrative për identifikimin dhe vendet në
dispozicion të truallit të propozuar pranë DRAKU Shkodër.

Sa më sipër, ju lutem të na informoni mbi ecurnë aktuale të procedurave për përcaktimin e
truallit ose çdo vendimarrje apo dokumentacion të miratuar deri në këtë fazë që është në
funksion të ndjekjes dhe koordinimit të mëtejshëm të veprimeve për zbatimin e këtij projekti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTOR RAJONAL

Ramir Hadri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH. A.
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 63 Prot

Shkodër, më 14.05.2026

V E N D I M

Nr. 06 datë 14.05.2026


**PËR MIRATIMIN E AKT VLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME
TË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME"
SH.A.**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "Tregu i shitjes me shumicë Fruta Perime Shkodër" Sh.a., e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër"; Statutit të Shoqërisë, Vendim Nr. 2 Dt. 13.05.2026 Të Këshillit të Administrimit, Akt Vlerësimi i Pasurisë së Paluajtshme Dt. 08.05.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Akt Vlerësimi të Pasurisë së Paluajtshme të Shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime Shkodër" Sh.a.
2. Shoqëria "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a të marrë masat e duhura administrative, procedurale dhe ligjore për njohjen e përfundimeve të nxjerra nga raporti.

PËR ASAMBLENËN E PËRGJITHSHME





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH.A
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Nr. 02 prot.

Shkodër, më 13 .05.2026

VENDIM
Nr. 02 Datë 13 /05 /2026
PËR MIRATIMIN E AKT VLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME
TË SHOQËRISË

Këshilli i Administrimit i Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a Shkodër, në të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër"; Statutit të Shoqërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Akt Vlerësimi të Pasurisë së Paluajtshme të Shoqërisë " Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta Perime Shkodër" Sh.a.
2. Shoqëria "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" Sh.a të marrë masat e duhura administrative, proceduriale dhe ligjore për njohjen e përfundimeve të nxjerra nga raporti

Denisa Domni

Elvin Brahimi

Griselda Dama





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH. A.
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 57 Prot

Shkodër, më 04.05.2026

V E N D I M

Nr. 05 datë 04.05.2026

PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME TË SHOQËRISË "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME SHKODËR" SH. A. DHE EMËRIMIN E VLERËSUESIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "Tregu i shitjes me shumicë Fruta Perime Shkodër" Sh.a., e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 19.07.2023 "Për Transferimin e Pronësisë së 67,21% të Aksioneve të Shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime", Sh.a Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër"; Statutit të Shoqërisë, Vendim Nr. 1 Dt. 04.05.2026 Të Këshillit të Administrimit dhe me Kërkesë të tij,

V E N D O S I:

1. Rivlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme të Pasurisë së Shoqërisë
2. Emërimin e Ing. Surri Dizdari, me Licensë profesionale Nr. Regj. Vp.1228/1 Shkalla e parë, me adresë Laggje Q. Stafa, Shkodër, email. surridizdariutlook.com, përfaqësues ligjor i subjektit Surri Dizdari Person Fizik, me NIPT L66402005A


PËR ASAMBLËNË E PËRGJITHSHME



AKT VLERESIMI PASURISE SE PALUJTESHME

PRONA: TREGU I SHITJES ME SHUMICE FRUTA-PERIME

SHKODER



Pergatitur nga Vleresues:

Ing. Syrri Dizdari

Nr. Lic. VP. 1228/1/shk. Pare

Date : 08.05.2026

Ing. Surri Dizdari: adresa: lagje- Q.Stafa rruga- Studenti pallati-Hipotekes
Adresa elektronike: surridizdari@outlook.com tel: 0693156007

Porositësi: SH A “tregu i shitjes me shumice fruta-perime” Shkoder

Pronari: SH A “tregu i shitjes me shumice fruta-perime”

Lloji pasurisëpaluajtshme: toke-trull, ndertesa

Vendndodhja - ZK. 1495 - Dobrac , bashkia Shkoder

**Vlerësuesi: Ing. Syrri Dizdari Nr. Lic. VP. 1228/1 shk. Pare
Lagje Q.Stafa, rruga Studenti, pallati Hipotekes Shkoder**

Data e vlerësimit: Date : 08.05.2026



1. Adresa dhe zona e vendodhjes pasurise

Prona object vlersimi pasuniaja nr. 152/19, ndodhet ne ne zonë periferike te qytetit Shkoder, pozicionu ne veri te qytetit, ne krahun e djathte te rruges nac. Shkoder – Hani Hoti (km. 2)

Simbas hartes kadastrale asht ZK. 1495 - vendose ne planshteten me indeks: K-34- 64-(177 – C) Nj/Ad. Rrethina, Dobrac , pjese e bashkise Shkoder.

Objekt I ketij vlersimi asht toke-trull dhe ndertesa te shoqerise: “tregu i shitjes me shumice fruta-perime”

2. Instruksione; te nderuar zoterinj.

Ne perputhje me instruksionet tuaja te dates 27/04/2026 kam pergatitur vlerësimin per pronën qe keni ne pronesi si “SH A “tregu i shitjes me shumice fruta-perime” “are+trull” me siperfaqe 31316 m2, ndertesa 2kat me siperfaqe 1463 m2, 120 m2, 45 m2 (gjithsejt 1351.5 m2 hipoteka)

Ky vleresim eshte bere ne perputhje me Manualin e Standarteve Europiane te Vleresimit me date 02.05.2026

Vlerësimi është bere ne përputhje me:

- ligj nr. 111/2018 Për Kadastrën, udhëzues i Bankes së Shqiperise “Për përgatitjen e vlerësimeve të pasurive të paluajtshme për qëllime të marrjes se kredive nga një institucion financiar,

-ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”,

-udhëzimi përbashkët nr. 5, datë 19.2.2026 “përpërcaktimin e procedurave të zbatimit të ligjit nr. 85/2025, “për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, për llogaritjen e bazës së tatueshme, paraqitjen dhe administrimin e kërkesës për rivlerësim, pagesën e tatimit të rivlerësimit, rregullat e procedurat për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pagesën e tëardhuravengatimiirivlerësimitnëbuxhetin e shtetit, si dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve”

-Urdhër Nr.1052, datë 2.12.2024 Për miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së tokave-trojeve dhe ndertesave tregtare në treg, sipas zonave kadastrale, përnjësitë e vetëqeverisjes vendore”

- udhëzimit të përbashkët nr. 34, datë 29.12.2023, “Përtatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”.

Duke pas parasysh qe Toka-Troje dhe ndertimet perfaqesojne vlerat ma te medha te pasunive te nje vendi, punen teme e kam mbeshtet ne zbatimin e standarteve profesionale, ndershmerise dhe besueshmerise me klientin per te cilin punojme.

Ne praktiken e punes teme, çdo vleresim qe kryej per subjektin, perpiqem qe te kem nivel te nalte mardhanjesh dy palse: Vleresues – Klient, jo vetem persa I perket procesit te vleresimit, por dhe ne mardhanjet e personalitetit ne lidhje me klientet.

Vleresimi eshte konfedincial dhe vetem per perdorimin tuaj dhe te institucioneve, per qellime te tjera nuk mund te perdoret nga persona te tjere, .Raporti si i tere apo referenca nuk mund te perfshihet ne asnje dokument te



shkruar, qarkore apo deklarate dhe as nuk mund te publikohet pa miratimin tim me shkrim per formen dhe kontekstin qe mund te perdoret.

Duke pasur parasysh instruksionet tuaja ne lidhje me pronen dhe pasi kam bere kerkimet e nevojshme, ne terren dhe axhensi imobilare

<https://www.indomio.al/https://kaktu.al/a>

<https://www.merrjep.al/>. <https://www.century21albania.com/>

<https://kaktu.al/al/njoftime/>.

Shkodra Craigslist (@shkodracraigslist)<https://www.shpi.al/prona/>.

kam kenaqesine t'ju raportoju si me poshte vijon:

3. Qëllimi

Porositësit e këtij raporti te pronës “tregu i shitjes me shumice fruta-perime”, duan te dijne vlerën e sotme te tregut te pronës, PER ARSYE RIVLERESIMI. Per: -Sipërfaqe prone:


- “toke-trull” me sipërfaqe 31316 m²

-Nga e cila sipërfaqe ndertimi prej 1351.5 m². Ku perfshihen:

-Ndertesa e magazinimit

-Ndertesa e zyrave financa etj.

-Ndertese WC



Ing. Surri Dizdari: adresa: lagje- Q.Stafa rruga- Studenti pallati-Hipotekes
Adresa elektronike: surridizdari@outlook.com tel: 0693156007

5. Përshkrimi.

Prona qe po rivlersohet "tregu i shitjes me shumice fruta-perime" asht nje siperfaqe toke- trull, me rreljev fushor, fillimisht ka pas nje siperfaqe 33000m², por por me krijimin e harkut per monumentin "5 Herojt e Vigut" siperfaqja ne fakt (simbas certifikates te pronesise **31316 m²**)

Kjo siperfaqe toke asht e rrethume me mure e kangjellate. Mbrenda ksaj siperfaqe prej 31316 m², ka objekte ndertimore: 1 kat (si: zyra, infirmjери, wc, vendroja, kapanone me strukture metalike "tetoje" etj.) dhe objekt 2 kat , si dhe infrastruktura qe mundeson funksionimin normal te ketij tregu.

Objektet ndertimore jane ndertu ne vitin 2006 - 2007.

Objektet ndertimore simbas pershkrimit teknik jane si ma poshte:

- **Ndertese 2 kat me funksion "Magazina"**

Ka siperfaqe ndertimi $S_n = 1286 \text{ m}^2$

Ndertesa ka konstruksion beton-arme

- kolona dhe trare b/arme.

-Mbulesa solete b/arme,


-Muratura blloqe betoni

Suvatime mbrenda dhe jashte

-Ne katin perdhe ka gjithsejt 22 ambjente magazinimi te vendosun ne dy krahet nga 11 ambjente.

-Ka koridor e mes per funksionimin e materialeve.

Ne katin nalt (kati pare -teknik) ka 22 zyra, qe komunikojne me magazinat poshte nepermjet shkallve te mbrendshme




Pjesa qe asht trajtu si 2kat asht nje siperfaqe ne nje hapsine ne dy krahet e koridorit me gjansi rreth 3m.

Ne dy faqet anesore te godines ka strehe (konsol) nga 3m gjasi

Shif poshte pamje te ketij objekti-magazine 2kat:



Pamje ballore



pamje anesore



Pamje e mbredshme e magazines, ku evidentohet pjesa ne mes 2kat

Ing. Surri Dizdari: adresa: lagje- Q.Stafa rruga- Studenti pallati-Hipotekes
Adresa elektronike: surridizdari@outlook.com tel: 0693156007

Surri Dizdari

fq. 9

-Ndertese 1 kat me funksion "zyra , financa, etj

Ka sipërfaqe ndertimi Sn = 120 m²

Ndertesa ka konstrukcion beton-arme

-Themele xokol b/arme

-Muret perimetral bllok betoni

Shtrese me pllaka


-Dyer, dritare d/alumin

-Ka rrjetin eelektrik


-Mbulesa. Solet b/arme

Suvatime mbrenda dhe jashte

Shif poshte pamje te ketij objekti- zyra finance 1kat:



Pamje nga para



pamje nga mbrapa

- Ndertese 1 kat me funksion "banjo - WC"

Ka sipërfaqe ndertimi $S_n = 45 \text{ m}^2$

-Konstruktion kolona+ trare b/arme

-Muraturat tulle


-Mbulesa- solete b/arme

Shtrese pllaka

-Dyer, dritare d/alumin

-Paisjet sanitare te nevojshme

Shif poshte pamje te ketij objekti- WC 1kat:



Pamje para dhe profil i WC

Surri

Infrastruktura e prones:

Prona object vleresimi qe ndodhet ne pjesen veriore te qytetit te Shkodres ne krah te rruges Shkoder – Koplik, rreth 17000 m2 ka siperfaqe e sistemume dhe te asfaltume, pjesa tjeter e tokes(are) asht e pa sistemume

Objektet qe jane mbrenda territorit kane akses me rrugen kryesore si nga Shkodra, po ashtu dhe nga M.Madhe, hyrja rrealizohet nepermjet rruges se hyrjes qe asht mbrenda rrethimit, shesheve funksionale te shtrume me beton,

Projekti dhe zbatimimi dhe aktualisht tregu funksionon mbrenda me kondicioneve urbane

Nuk kam ba investigime per kushtet e sherbimeve kryesore si:


- Furnizimi me energji elektrike
- Furnizimi me uje te pijshem
- Kanalizimet e ujnave te bardha e te zeza.

Per kry kete vlersim asht supozu se sherbimet e masiperme funksionojne normalisht





sheshi i hyrjes ne treg



pamje mbrapa ndertesave pa aktivitet

6. Pronësia Për hartimin e këtij raporti me është vene ne dispozicion

-Certifikate per rregjistrim Pronesie ne favor te personit juridik: Tregu i Shitjes me Shumice (Fruta – Perime) me nr. Personal K67401001J. Leshu me date 04.05.2023

Kuzizohet: veri - pasunia 152/15 (stacioni misrit)

Jugu - pasunia 152/15152/7, 152/17, 152/4

Lindja – 151/57, 151/10, 151/72, 151/136, 151/64, 151/46,

151/144, 151/142151/162, 151/112 (prona private)

Perend. – pasunia 353 (rruga nac. Shkoder-Koplik)

Simbas ketij dokumenti pronésie, pasunia prona ndodhet ne zone kadastrale 1495, ka numer pasurie 152/19, kodi unik 1495018155 , lloji pausurise toke are + trull +ndertesa:

Siperfaqe toke gjithsejt: 31356 m². Nga ketu:

Siperfaqe trulli = 4055.4 m²,

Ndertime me siperfaqe 1351.5 m²

-Harta treguese nga A SH K bashkangjit certifikates.


Ky dokument pronésie me asht vu ne dispozicion nga kerkuesi i ketij vlersimi-
- SH A "tregu i shitjes me shumice fruta-perime" Shkoder

Sqaroj qe: mbi siperfaqen e tokes-trull prej 31316 m² ne pronesi te "tregu i shitjes me shumice fruta-perime" ndodhet dhe nje objekt 3kat ku asht e instalume A K U Drejtoria Rajonale Shkoder.

Siperfaqja e tokes e rethume qe posedon ky institucion asht: 2350 m²

Shif Ortofoton poshte, ku evidentohet hapsina qe xen A K U





7. Baza Vlerësimit

Vlerësimi i pronës ka për qëllim të vlerësojë pronën me metodën e vlerësimit që përdoret aktualisht deri më maj 2026, në një treg të lirë dhe të hapur.

-Toka- Trull është vlerësuar tuj kombinuar metodën e zhvillimit me metodën e krahasimit me shitjet e periudhës 2025 deri më maj 2026 për pronë të ngjashme si në vendndodhje dhe në sipërfaqe.

Ing. Surri Dizdari: adresa: lagje- Q.Stafa rruga- Studenti pallati-Hipotekes
Adresa elektronike: surridizdari@outlook.com tel: 0693156007

fq. 15

Objektet ndertimore, jane ndertu per qellime specifike qe ti sherbejne ketij Tregu i shitjes me shumice fruta-perime” me te gjith infrastrukturen e nevojshme , dhe nuk mund te funksionoj ndryshe pervec sic jane konceptu dhe ndertu. Per kete arsye vlersimin do ta baj me metoden e Kostos ndertimore, duke trajtu dhe amortizimin faktik, mbasi keto objekte kane nje moshe ndertimi 20 vjecare, (dhe nuk i asht kry ndonje rikonstrukcion)

Ne kete rraport vlersimi, do te vleresoj “ token- trulli” dhe ndertesat kapitale, bazu ne te dhanat e siperfaqeve qe rrezultojne ne Certifikaten e pronesisë.

Bazu ne konceptin teorik qe:

Vlera e tregut te lire perkufizohet simbas K.Nd. te Standarteve te Vlersimit. “Shuma e vlersuar per te cilen nje prone shkembet ne daten e vlersimit midis nje shitesi te vullnetshem dhe nje bleresi te vullnetshem, ne nje transaksion normal, mbas nje marketingu te pershtatshem, ku palet ne menyre te vetedijshme dhe pa detyrim”

Vlera e kësaj prone është llogaritur ne baze te supozimeve te bëra gjate këtij raportit, duhet nënvizuar se pasuria ndodhet nënjë zone periferike dhe tregtare qyteti Shkoder.

Për qellim te vlerësimit nuk marrim parasysh ofertën e përdoruesit aktual.

Sama siper ne perfundim mendimi im per vleren e prones asht:

Duke u bazuar ne supozimet e bëra gjate raportit dhe nga llogaritjet e kryme, mendimi im asht:

Vlera absolute e prones “Toke-Trull me Sip. 31356 m2, duke vlersu me 2000 lek/m2 asht: 62 712 000 lek



Vlera absolute e pronës "Ndertese" me Sip. 1351.5 m², duke vlersu bazu ne Udhezimin nr. 1, date 10.09.2025 te K.M. per koston mesatare te ndertimit qe per qytetin Shkoder asht: 482291 lek /m². Mekense objektet ndertimore kane moshe 20 vjecare, dhe nuk i asht kry asnje rikonstrukcion, do te aplikoj Amortizim 10 %.

Per rrjedhoj Vlera e ndertimit rrezulton 43 462 lek

Bazu ca sqarum ma nalt, Vlera e objekteve paraqiten si ma poshte.

- Toke-Trull	Sip. 31356 m ²	62 632 000 lek
- Ndertese 2 kat "Magazina"	S=1286.5 m ²	55 913 863 lek
-Ndertese 1 kat "Zyra , financa"	S=120 m ²	5 215 440 lek
- Ndertese 1 kat "banjo - WC"	S= 45 m ²	<u>1 955 790 lek</u>

VLERA TOTALE

125 717 093 lek

Rraport Vlersimi permбан:

- Akti shkresor flet 19
- Ortofoto simbas Asig flet 2
- Çertifikate per Vertetim Pronesie flete 1
- Harta treguse flet 1
- Foto te objektit cop 10
- Liçenca profesionale flet 2
- Dokumenti rregjistrimit ne organet Tatimore

Pergatitur nga Vleresues:

Ing. Surri Dizdari

Nr. Lic. VP. 1228/1 shk. Pare

Date : 08.05.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHITËTËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
TREGU I SHITJES SHUMICE FRUTA-PERIME	K67401001J	1/1

Numri i Pasurisë	152/19		
Kodi Unik	1495018155		
Zona Kadastrale	1495		
Lloji i Pasurisë	ARE+TRUALL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 31316	Truall: 4055.4	Ndërtesë: 1351.5
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	SHKODËR, SHKODER, Rr.: DOBRAC		

DREJTORI

Onid Bejleri

Onid

Bejleri

Digitally signed by:
Onid Bejleri
Date: 2023.05.04
01:00:29 +02'00'

Data e lëshimit 04/05/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkoder
Date: 2023/05/04 12:42:03 +02'00'
K67401001J2023050412415683L1014



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
te një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)


Mblotitur me VKN: 782; Datë 07.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 432 , datë 19.7.2023



401 Pa

P Ë R

TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 67.21 % TË AKSIONEVE
TË SHOQËRISË “TREGU I SHITJES ME SHUMICË
FRUTA-PERIME”, SH.A., SHKODËR, NGA MINISTRIA
E FINANCAVE DHE EKONOMISË TE BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 4, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transferimin e pronësisë së 67.21 % të aksioneve të shoqërisë “Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime”, sh.a, Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA